KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË

# NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit:** **10.04.2025**

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **623-25-2776-5-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtar**: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË** | | |
| **Adresa Postare**: **XHELAL HAJDA TONI** | | |
| Qyteti: **RAHOVEC** | Kodi postar: **21000** | Vendi: **Kosovë** |
| **Personi kontaktues**: **Astrit Mullabazi** | | Telefoni: **+38 20045316** |
| Email: **prokurimi.rahovec@gmail.com** | | Faksi: |
| Adresa e Internetit (*nëse aplikohet*): **https://kk.rks-gov.net/rahovec/** | | |

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

***Nëse po***, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:**
**Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahovecit në Xërxë – Lot 2 – vazhdim – Ritenderim**

**II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit**
*(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)*

| ☒ **Punë** | ☐ **Furnizime** | ☐ **Shërbime** |
|---|---|---|
| ☒ Ekzekutim<br>☐ Plani dhe ekzekutimi<br>☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa | ☐ Blerja<br>☐ Qira financiare (lizing)<br>☐ Qira<br>☐ Blerje me këste<br>☐ Një kombinim i këtyre | |

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
**Në Komunën e Rahovecit**

**II.1.3) Njoftimi përfshinë**

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

**II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë** *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

**Ekzekutimi i kontratës:**

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

**Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj**

**II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës**
**Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahovecit në Xërxë – Lot 2 – vazhdim – Ritenderim**

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):**

45233222-1

**II.1.7) Variantet pranohen**

**Po** ☐ **Jo** ☒

**II.1.8) Ndarja në Pjesë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,*** tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

**II.1.9) Informacione lidhur me pjesët** (*nëse aplikohen)*

| Nr. i pjesës | Emërtimi i grupit | Përshkrimi i shkurtër |
|---|---|---|
| | | |

**Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:**

**II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 4,976,638.92**

### II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm** *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
**Sipas Përshkrimit të Çmimeve**

### II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **24** apo ditë (nga dhënia e kontratës)
*apo*
Fillimi
Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

**III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit**

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % e vlerës së kontratës** % e vlerës së kontratës

**III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata** *(nëse aplikohet)*:
**Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimit të Rregullores Nr. 001 2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në**

| |
|---|
| **emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7 Deklarata per themelim te grupit, është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.** |
| **III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës**<br>**Po** ☐ **Jo** ☒<br><br>***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta |

## III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

| **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rks-gov.net** | **Dëshmia 1 Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi I Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit**<br>**Dëshmia 2 Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.**<br>**Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.**<br>**Dëshmia 3 Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore.**<br>**Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik të propozuar për shpërblim me kontrate në sjelljen e dokumenteve te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën e tij ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.** |
| **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |

| | |
|---|---|
| Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit | Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje |
| Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së | Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje |

| III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se 9,950,000.00 €uro | Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë |
| Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, në vlerë prej 1,400,000.00 €, mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania, duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin ne fjale, ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar, duke emërtuar projektin per te cilin lejohet kredia; | Dëshmia 2 Deklaratë nga banka që dëshmon se Operatori Ekonomik, ka mjete të gatshme në xhirollogari ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar për ketë projekt, Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt; |

| III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: | *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* |
|---|---|
| Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 50 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani; | Dëshmia 1 Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 50 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite), pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, per secilin punëtor te prezantuar ne liste duhet te dëshmohet përmes listës së ATK-së si dhe dëshmi nga Banka (Lista e pagave) të Operatorit ekonomik që dëshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtorëve për gjashtë (6) muajt e fundit duke bashkangjitur dëshminë (konfirmimin) bankar; |
| Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf professional 2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte te menaxhuara ne zgjerim te rrugëve; 2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka udhëhequr projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte te udhëhequr ne zgjerim te rrugëve; 2.3. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, ose Bachelor i Ndërtimtarisë – | Dëshmia 2 • Diplomat përkatëse – Kopje; • CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri); • Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje per projekt, marrëveshja duhet te jete e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03 L-212; • Një deklarate me shkrim nga Inxhinerët e Stafit Profesionale, ku deklarojnë se do të jenë të angazhuar për këtë projekt, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar nga vetë inxhineri; • Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi; • Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, duhet të dorëzohet në origjinal, i |

| | |
|---|---|
| **Drejtimi Konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka realizuara projekte në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve; 2.4. Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve; 2.5. Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i Komunikacionit me (5) pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit te rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve; 2.6. Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës ose Master diplome, me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve;** | **nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2;<br>• Licenca e Kopje e Gjeodetit, për pikën 2.4;** |
| **Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimin dhe zgjerimit të rrugëve, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 7,450,000.00 €uro;** | **Dëshmia 3 Lista e punëve te realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes se Tenderit, në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimin dhe zgjerimit të rrugëve, të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi (i) kur punët janë bërë për një Autoritet Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar, (ii) kur punët janë bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;** |
| **Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO<br>- ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) - ISO 39001-2012 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugore) - BS PASS 99-2012 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Integruar) - ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit) - ISO 28001-2007 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë për Zingjirin e Furnizimit)** | **Dëshmia 4 Certifikatat Kopje dhe Valide;** |
| **Kërkesa 5 Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për** | **Dëshmia 5 Kopje e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopje e Licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve** |

| | |
|---|---|
| **Siguri dhe shëndet në punë, se ka kryer vlerësimin e riskut konform ligjit 04 L-161 dhe së paku Njëzetepesë (25) punëtor të jenë të trajnuar certifikuar për siguri dhe shëndete në punë, (punëtor në kuadër të Kërkesë Nr. 1 min. 50 punëtor);** | **nga siguria dhe shëndeti në punë, po ashtu Certifikata për punëtor të trajnuar certifikuar për siguri dhe shëndetë në punë;** |
| **Kërkesa 6 Operatori Ekonomik duhet te ketë Bazë për prodhimin e Asfaltit me kapacitet min. 240t h, te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim, Bazë për prodhimin e Betonit te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim, Gurthyes të licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim;** | **Dëshmia 6 Kopje e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni per Miniera dhe Minerale në pronësi. Ne rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje per furnizim, duhet specifikuar projektin dhe kohëzgjatjen e tij. Marrëveshja duhet te jetë orgjinale mes qiradhënësit dhe qiramarrësit;** |
| **Kërkesa 7 Operatori Ekonomik duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet;** | **Dëshmia 7 Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe plani i menaxhimit duhet te jetë i vulosur nga kompania;** |
| **Kërkesa 8 Operatori Ekonomik duhet te ofroj se bashku me oferte Plani Dinamik per realizimin e projektit;** | **Dëshmia 8 Plani dinamik sa me i detajuar – Gantogrami, i punuar Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, dhe duhet te jetë i nënshkruar dhe vulosur nga kompania;** |
| **Kërkesa 9 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;** | **Dëshmia 9 Operatori ekonomik duhet të plotësojë listën e pajisjeve sipas kërkesës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit, Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten edhe dëshmitë mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listës se ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit), Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (Faturë, DUD ose kontratat e shitblerjes. etj.)<br>Vëmendje!<br>Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezencë të noterit; Dëshmitë per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listës se bashkangjitur ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit, Gjithashtu të epen karakteristikat gjegjësisht specifikat teknike të veçanta per secilën nga pajiset, Dëshmitë duhet te jene te dukshme;** |

## III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

**Po** ☐ **Jo** ☐

| |
|---|
| **III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**<br><br>***Nëse po,*** referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse |
| **III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**<br>**Po** ☐ **Jo** ☐ |

## NENI IV: PROCEDURA

## IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

| **IV.1.1) Lloji i procedurës** |
|---|
| ☒ **E hapur** |
| ☐ **E kufizuar** |
| ☐ **Konkurruese me negociata** |
| ☐ **Kuotim i Çmimit** |
| **IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim** *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*<br><br>Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë: |
| **IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave** *(procedurë konkurruese me negociata)*<br><br>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme<br>**Po** ☐ **Jo** ☐<br>në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar<br><br>Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë<br>kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata<br>**Po** ☐ **Jo** ☐ |
| **IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është**: |
| **IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik**<br><br>Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒<br><br>Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik: |

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

| |
|---|
| ☐ **Çmimi më i ulët** |

*ose*

☒ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

| | Nënkriteret | Koeficient |
|---|---|---|
| 1 | Çmimi | 0.70 |
| 2 | Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max. 36 Muaj | 0.30 |

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

**IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë**

**Po** ☐ **Jo** ☒

***Nëse po,***

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

**Po** ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

***Nëse po,*** çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

**IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:***

***data*** **05.05.2025** ***koha*** **14:30:00** ***vendi*** **https e-prokurimi.rks-gov.net**

**IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:**

☒ **Po** ☐ **Jo**

***Nëse po,*** jep arsyetim **Me Urdhëresë nga Kryetari i Komunës me Nr. 5571, Nr. i faq. 60, datë 08.04.2025, për përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore gjatë aktiviteti të prokurimit, e cila Urdhëresa arsyetohet, duke cekur Arsyetim Pas ndërprerjes së kontratës me marrëveshje dhe pas ndryshimeve që duhet të bëhen në projekt, si të domosdoshme për kompletimin e këtij projekti, kërkojmë që kjo procedurë të ketë afate të përshpejtuara. Në kuadër të këtij projekti, janë përfshirë nevoja për instalimet nëntokësore të rrjetit elektrik, kanaleve atmosferike dhe fekaleve, që janë të vjetra, që në shumicën e rrugëve kemi deformime dhe plasaritje për shkak të instalimeve të vjetra dhe specifikave. Përveç kësaj, kjo rrugë ka nevojë urgjente largimin e shtyllave elektrike, që janë përgjatë brezit rrugor në të dyja anët e rrugës (ky projekt ka paraparë edhe bashkëpunimin me ndërmarrjet publike, si K.R.U. "Gjakova", KEDS-i, kompanitë kabllore), që janë si pasojë e projekteve të vjetruara elektrike e kabllore e që duhen trajtuar sepse gjendja aktuale e këtyre shtyllave dhe elementeve të tjera nëntokësore janë rrezik permanent për qytetaret. Ky projekt e ndihmon dhe i jep impakt të ri trajtimit të rrugës 4-korsi në drejtim të qytetit të Rahovecit. Për ta kompletuar në tërësi këtë projekt, është më se e nevojshme që të zhvillohet procedura e afateve të përshpejtuara kohore duke u bazuar gjithherë në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës.**

**IV.3.4)** A është e nevojshme siguria e tenderit:

**Po** ☒ **Jo** ☐

***Nëse po***, vlera e sigurisë së tenderit **99,000.00 €uro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj

**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**

Deri më: data: ditët **90** apo muajt

| |
|---|
| **IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:**<br><br>**data 05.05.2025 koha 14:30:00 vendi https e-prokurimi.rks-gov.net** |

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

| |
|---|
| **Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.** |

### V.2) INFORMACIONET SHTESË

| |
|---|
| **Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.**<br>*Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*<br>**• Autoriteti Kontraktues Komune Rahovecit ju informon se sipas vendimit te KRPP – se Nr. 91 2018 dhe RRUOP, që tenderi duhet të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike (ne asnjë mënyrë ne versionin tjetër). Ky është kusht i tenderit i cili duhet respektuar për te mundësuar pranimin e ofertës si te “përgjegjshme” administrativisht. • Në pamundësi teknik për të ngarkuar në sistem e prokurimit projektin detal, ju informojmë se komplet projektin mund te merrni ne Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit, ne forme fizike.** |